**VENDIM**
**Nr.13, datë 28.1.2008**

**PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR NDËRTIM, INSTALIM DHE SHFRYTËZIM TË CENTRALEVE ELEKTRIKE ME ERË, SI DHE PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA KËTO CENTRALE, SHOQËRISË "ALB WIND ENERGY" SHPK PËR PROJEKTET VISU DHE TERPAN**

Në zbatim të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" me ndryshimet përkatëse, neni 13, pika 1, germa "a", si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007 "Për miratimin e rregullores për procedurat e licencimit", neni 11, pika 1, neni 13, pikat 1 dhe 2, vendimit nr.44, datë 24.7.2007 "Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", neni 15, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.1.2008, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga "ALB Wind Energy" sh.p.k., për marrje licence për aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centralit elektrik me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga këto centrale,

VENDOSI:

I. Dhënien e licencës shoqërisë "ALB Wind Energy" sh.p.k., në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike për projektin VISU me fuqi 140 MW dhe projektin TERPAN me fuqi 85 MW, duke plotësuar kushtet e mëposhtme:

1. Brenda një afati kohor 12-mujor të realizojë:

- Sigurimin e dokumenteve të pronësisë, duke realizuar kalimin nga premtim shitjeje në titull pronësie dhe realizimin e kontratave me institucionet shtetërore apo me subjektet private, për huapërdorje ose qeramarrje, për të gjithë sipërfaqen e nevojshme për realizimin e projektit.
- Kryerjen e një studimi fisibiliteti, që kushtëzohet me instalimin e kullave vrojtuese për të eksperimentuar në kushtet reale dhe nxjerrjen e konkluzioneve definitive për projektin e zbatimit. Përcaktimi në këtë studim edhe i kostos së prodhimit të energjisë elektrike. Ky studim të paraqitet në ERE përpara fillimit të zbatimit të punimeve. Për këtë shoqëria duhet të sjellë grafikun e rishikuar të punimeve.

2. Shoqëria "ALB Wind Energy" sh.p.k., duhet të paraqesë pranë ERE-s, marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a.-në, përpara fillimit të ndërtimit të objektit, ku të jenë të specifikuara detyrimet e ndërsjella, që rrjedhin nga Kodi i Transmetimit.

3. Shoqëria "ALB Wind Energy" sh.p.k., do të respektojë detyrimet e shërbimit publik që do të rrjedhin në zbatim të nenit 25 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike".

4. Koha e zbatimit të gjithë projektit përfshirë dhe kolaudimin e veprës, duke iu referuar datës së lëshimit të licencës të jetë 36 muaj.

II. Afati i vlefshmërisë së licencës të jetë 30 vjet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
**Bujar Nepravishta**